



FORMULAR PËR SYLLABUS
HISTORI KOMBËTARE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Universiteti Prizrenit ” Ukshin Hoti” Fakulteti i Edukimit
Titulli i lëndës:	Histori Kombëtare
Programi:	Fillor
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i dytë - Semestri i katërt
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Fakulteti i Edukimit
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.asoc.dr.Fahredin Shabani,
Detajet kontaktuese:	fahredin.shabani@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kursi përfshinë tematikën vijuese: Paraardhësit e shqiptarëve – historinë e Ilirëve; Shqiptarët në Mesjetë- Principatat shqiptare; Shqiptarët nën sundimin Osman – rezistenca e tyre; Rilindja kombëtare shqiptare; Përpjekjet e shqiptarëve për autonomi – Lidhja e Prizrenit dhe Pejës; Formimi i shtetit Shqiptar (1912) dhe copëtimi i trojeve shqiptare; Shqiptarët gjatë Luftës Parë Botërore; Shqiptarët në mes dy luftërave botërore – Shqipëria dhe shqiptarët në Jugosllavi; Kultura Iliro-shqiptare gjatë rrjedhave historike; Shqiptarët në Luftën e Dytë botërore dhe Republika socialiste e Shqipërisë dhe shqiptarët në Jugosllavi pas Luftës Dytë Botërore</p> <p>Kursi është konceptuar për të përfshi sa më shumë tematika nga jeta, kultura dhe historia kombëtare – pa cenuar historinë e popujve tjerë.</p> <p>Njohuritë: Studentët duhet të fitojnë njohuri solide mbi rrjedhat reale shoqërore e historike dhe domosdoshmërinë e sjelljes bazuar në to; nxitjen e tyre për të kuptuar rëndësinë e njohjes së historisë</p>

	<p>kombëtare; njohjen me progresin dhe të metat në rrjedhat e zhvillimit gjatë historisë nga kohët më të vjetra deri në atë bashkëkohore; njohjen se sjellja e qytetëruar është një bazament për progres kombëtar e shtetëror.</p> <p>Shkathësitë: Nëpërmjet të njëjësive të përgjithshme të krijohen shkathësi motorike për njohjen e ngjarjeve më të rëndësishme historike; të mësohen të transmetojnë drejt historinë kombëtare të tjerët; të krijohen shprehje motorike për respektimin e ngjarjeve historike; arritja e shkathësisë për të bartur të nxënësit e tyre njohuri solide mbi historinë dhe kuptimin e saj si vazhdimësi e jetës.</p> <p>Qëndrimet: Studentët duhet të kuptojnë rëndësinë e historisë së kaluar për të ndërtuar të ardhmen; të jenë bartës dhe ndihmës të kuptimit të kaluarës për të mos përsëritur gabimet në të ardhmen; që heroizmi nëpër shekuj të jetë frymëzim për flim për atdheun e vetë dhe vlerat kombëtare.</p>
<p>Qëllimi i lëndës:</p>	<p>Qëllimi i këtij kursi është që të studentet të marrin njohuri relevante mbi jetën, historinë dhe përpjekjet e shqiptarëve për mbijetesë dhe emancipim kombëtar. Te kuptojnë raportet me pushtuesit dhe fqinjët si dhe copëtimin e trojeve shqiptare. Të njihen me origjinën e popullit – nga Ilirët deri te shqiptarët, Historinë mesjetare shqiptare, Pozita e shqiptarëve nën sundimin Osman dhe rezistenca e tyre. Lëvizjen kombëtare shqiptare deri te Shpallja e Pavarësisë 1912. Njohja me historinë bashkëkohore nga Pavarësia e Shqipërisë deri te Pavarësia e Kosovës. Aftësimin e studentëve-arsimtar të ardhshëm për transmetim relevant dhe objektiv të historisë të nxënësit e tyre.</p>
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p>Pas përfundimit të suksesshëm të këtij kursi studentët duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ kuptojnë ndodhitë më të rëndësishme historike ➤ kuptojnë rëndësinë e mësimin të historisë kombëtare ➤ kuptojnë sakrificat që dha kombi për të ruajtur trevat e veta ➤ bartin drejtë në sasi dhe cilësi njohurit për historinë kombëtare të nxënësit e tyre

	<p>➤ kuptojnë rëndësinë e mësimin të historisë kombëtare si pjesë e kulturës qytetëruese por pa ra në grackat e urrejtjes ndaj të tjerëve.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	3	2	6
Projektet,prezantimet ,etj			
Totali			150 orë 6 ECTS
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Çdo javë përveç kursit përkatës ligjërues, një pjesë e ligjëratave do të ndahet për të forcuar temën duke ushtruar ushtrime.</p> <p>Metodat interaktive dhe të qasjes komunikuese mbizotërojnë në zhvillimin e kurrikulave të kërkuara për këtë kurs.</p> <p>Ligjërata, diskutime, punë në grupe me përgjegjësi të secilit grup, prezantime të detyrave të shtëpisë, vlerësim të vazhdueshëm, etj ...</p>		
Vlerësimi:	<p>Vlerësimi me gojë dhe me shkrim:</p> <p>Pjesëmarrja në ligjërata: 10%</p> <p>Pjesëmarrja në aktivitete:10%</p> <p>Testi semestral I: 20%</p> <p>Testi semestral I: 20%</p> <p>Vlerësimi final:40%</p> <hr/> <p>Totali:100%</p>		
Literatura			
Literatura bazë:	<p>1. Historia e popullit shqiptar-për shkolla te mesme, Enti i teksteve – Prishtinë, 1996.</p> <p>2. Noel Malcolm, Kosova një histori e shkurtër, Koha-Prishtinë & Libri shkollor-Tiranë, botimi dytë, 2001.</p>		

	3. Akademia e shkencave Shqipërisë, Historia e popullit shqiptar, vll. I, II, III dhe IV, Toena, Tiranë, 2002-2009.
Literatura shtesë:	<p>*Nina Smirnova, Historia e Shqipërisë përgjatë shek. XX, Ideart, Tiranë, 2004.</p> <p>*Serge Metais, Histori e shqiptarëve nga Ilirët deri te Pavarësia e Kosovës, Tiranë, 2006.</p> <p>*Jacques Burcart, Shqipëria dhe shqiptarët, Dituria, Tiranë, 2006.</p> <p>*Bernard Lory, Evropa Ballkanike nga 145 deri në ditët tona, Dituria, Tiranë, 2007.</p> <p>*Shaban Braha, Gjenocidi serbomadh dhe Qëndresa shqiptare (1844-1990), Lumi-T, Gjakovë, 1991.</p> <p>*Stephen Schwartz, Kosova- prejardhja e një lufte, rrokullia, Prishtinë, 2006.</p> <p>*Aleksander Stipçeviq, Ilirët, Prishtinë, 1980.</p>

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Njohja e studentëve me Sylabusin studimor dhe literaturën-njohje reciproke
<i>Java e dytë:</i>	Banorët e hershëm të trojeve shqiptare- Ilirët
<i>Java e tretë:</i>	Historia mesjetare e shqiptarëve
<i>Java e katërt:</i>	Pushtimet osmane dhe rezistenca shqiptare
<i>Java e pestë:</i>	Shqiptarët nën sundimin osman
<i>Java e gjashtë:</i>	Rilindja Kombëtare shqiptare
<i>Java e shtatë:</i>	Testi i parë intermedial
<i>Java e tetë:</i>	Përpjekjet e shqiptarëve për autonomi
<i>Java e nëntë:</i>	Kryengritjet shqiptare 1908-1912 - formimi i Shqipërisë së pavarur dhe copëtimi i trojeve shqiptare
<i>Java e dhjetë:</i>	Shqipëria dhe shqiptarët jashtë saj 1912-1918
<i>Java e njëmbëdhjetë</i>	Shqipëria dhe shqiptarët jashtë saj në mes dy luftërave botërore
<i>Java e dymbëdhjetë</i>	Kultura iliro-shqiptare ndër shekuj
<i>Java e trembëdhjetë</i>	Testi i dytë intermedial
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	Shqiptarët gjatë Luftës Dytë Botërore (1939-1945)

<i>Java e pesëmbëdhjetë</i>	Shqipëria socialiste dhe Kosova pas Luftës dytë botërore deri në Pavarësinë e Kosovës
-----------------------------	---

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p><i>Studentët janë të obliguar :</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Studenti duhet të respektojë orarin e ligjëratave dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore. • Ti përmbahet të gjitha rregullave edukativo-arsimore. • Studenti duhet të jetë i përgaditur për ligjëratë duke qenë të pajisur me librin përkatës dhe fletoren për shënime. • Në respekt të kolegëve të tyre studentë, ata duhet t'i ndalojnë telefonat personal gjatë mëimit. • Studenti duhet të jetë pjesëmarrës aktiv në ligjëratë, (meqenëse libri i paraparë për zhvillimin e lëndës, është mjet i cili temat kryesisht i trajton në formë të ushtrimeve, dhe si i tillë kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm, në mes të mësimdhënësit, studentëve dhe librit). • Studenti është i obliguar të paraqes dhe posedoj ID kartelën në kolokfiume dhe në testin përfundimtar.

Shënim

Pjesëmarrja është parakusht për studentët që dëshirojnë të fitojnë njohuri të duhur të këtij kursi. Studentët që ndjekin rregullisht kursin do të jetë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë aktive në klasë, duke dhënë kontributin e tyre konkret gjatë ligjëratave interaktive dhe gjatë ushtrimit. Prandaj, kontributi i tyre për pjesëmarrje dhe të mësuarit dhe detyrat e tyre do të vlerësohen gjatë gjithë semestrit, në përqindje në bazë të kritereve të përcaktuara paraprakisht.

Bartësi i lëndës:

Prof.asoc.Dr. Fahredin Shabani